

VENDIM
Nr. 110/2024

PËR MIRATIMIN E ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE
TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË PAS MBARIMIT TË MANDATIT
TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e organikës dhe klasifikimin e pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2025 deri në datën 30.6.2025.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 12.12.2024.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË
PAS MBARIMIT TË MANDATIT TË KOMISIONIT
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

I. SEKRETAR I	I-1	(1)
PËRGJITHSHËM		
II. DREJTORIA E		(4)
MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE		
DHE MARRËDHËNIEVE ME		
MEDIAN DHE PUBLIKUN		
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	2
Specialist jurist	IV-1	1
III. DREJTORIA EKONOMIKE		(12)
DHE E SHËRBIMEVE		
MBËSHTETËSE		
Drejtor	I-4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT ***	IV-1	1
Specialist protokolli/arkivi ****	IV-1	4
Magaznier	VI	1
Shofer/korrier	V	1
Punonjës mirëmbajtje	III	1
Punonjës pastrimi	II	1
Total		17

Shënim:

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

***** Punonjësit administrativë përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion, apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njërën prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.